



Udhëzimi 18

Shtator 2016

Prokurimi publik

Koncesionet dhe PPP-të

PËRMBAJTJA

- [Zhvillimi i legjislacionit të BE-së mbi koncesionet](#)
- [Çfarë janë koncesionet?](#)
- [Përdorime të ndryshme të termit “koncesion” sipas ligjeve kombëtare](#)
- [Koncesionet që përfshijnë një kombinim të punëve dhe shërbimeve](#)
- [Çfarë është një PPP?](#)
- [Si zbatohen Direktivat ndaj PPP-ve?](#)
- [Koncesionet në sektorin e shërbimeve](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Zhvillimi i legjislacionit të BE-së mbi koncesionet

Para reformës së rregullave të prokurimit të Bashkimit Evropian (BE) në vitin 2014, dhënia e koncesioneve të punëve publike ishte subjekt i rregullave bazë të Direktivës 2004/18/KE.¹

Dhënia e koncesioneve të shërbimeve me interes ndërkufitar ishte subjekt i parimeve të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian² (TFBE ose Traktati), në veçanti i parimeve të lëvizjes së lirë të mallrave, lirisë së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, si dhe në parimet që dalin nga TFBE-ja, të tilla si trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, njohja reciproke, proporcionaliteti dhe transparenca. BE-ja vlerësoi se kishte një risk të pasigurisë ligjore në lidhje me interpretime divergjente të parimeve të Traktatit nga ligjvënësit kombëtar dhe dallimet e gjera midis legjislacioneve të shteteve të ndryshme anëtare. Ky risk u konfirmua nga jurisprudenca e gjerë e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED), e cila ka trajtuar vetëm pjesërisht disa aspekte të dhënies së kontratave të koncesionit. Mungesa e rregullimit të duhur të koncesioneve kishte rezultuar edhe në mungesë efikasiteti të konsiderueshme ekonomike dhe kishte pasur një ndikim negativ në marrjen e vlerës më të mirë të parasë publike.

Direktiva 2014/23/BE për dhënien e kontratave të koncesionit (Direktiva e Koncesioneve)³ u miratua për të trajtuar këto sfida duke krijuar një kuadër më të qëndrueshëm ligjor për autoritetet publike dhe operatorët ekonomikë për të garantuar mosdiskriminim, akses të drejtë në tregjet dhe konkurrencën në mbarë BE-në për koncesionet me vlerë të lartë.

Çfarë janë koncesionet?

Koncesionet janë të përcaktuara në Direktivën e Koncesioneve si koncesione të punëve ose të shërbimeve, ku:

- **“Koncesioni i punëve”** i referohet "një kontrate me shpërblim në para të lidhur me shkrim me të cilën një ose më shumë autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore i besojnë kryerjen e punimeve një ose më shumë operatorëve ekonomikë, shpërblimi për të cilën konsiston ose vetëm në të drejtën për të shfrytëzuar veprat që janë objekt i kontratës ose në këtë të drejtë bashkë me pagesën”;
- **“koncesioni i shërbimeve”** i referohet "një kontrate me shpërblim në para të lidhur me shkrim me të cilën një ose më shumë autoritete kontraktore apo subjekte kontraktore i besojë sigurimin dhe menaxhimin e shërbimeve të tjera dhe jo kryerjen e punëve një ose më shumë operatorëve ekonomikë, shpërblimi i së cilës përbëhet ose vetëm nga e drejta për të shfrytëzuar shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë bashkë me pagesën”.

Dhënia e një koncesioni duhet të përfshijë transferimin tek koncesionari të një **risku** operativ gjatë shfrytëzimit të këtyre punëve ose shërbimeve që përfshijnë riskun e kërkesës ose të ofertës, ose të dyja. Koncesionari duhet të marrë përsipër riskun operativ në kushte normale të operimit. Supozimi i riskut operativ do të thotë se koncesionari nuk është i garantuar për rikuperimin e investimet e bëra apo shpenzimeve të bëra për operimin e punëve ose të shërbimeve që janë objekt i koncesionit. Risku i transferuar duhet të përfshijë "ekspozimin e

¹ Direktiva 2004/18/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik, 31 mars 2004.

² Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian*, C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin e Prokurimit Traktati referohet si "TFBE" ose "Traktati".

³ Direktiva 2014/23/BE për dhënien e kontratave të koncesionit, 26 shkurt 2014.

vërtetë ndaj oscilacioneve të tregut, të tillë që humbjet e mundshme të vlerësuara të shkaktuara nga koncesionari nuk janë thjesht nominale ose të papërfillshme”.

Në përputhje me përcaktimet e mësipërme, dy faktorët kryesorë janë të një rëndësie të veçantë kur përcaktohet se nëse një marrëveshje klasifikohet apo jo brenda përkufizimit të një koncesioni:

- **Tarifa koncesionare**⁴: Burimi i shpërblimit nuk duhet të vijë vetëm nga autoriteti kontraktor në formën e pagesës së një çmimi, por pjesërisht ose ekskluzivisht nga e drejta për të shfrytëzuar veprat/shërbimeve. Në praktikë kjo do të thotë se një pjesë ose i gjithë shpërblimi vjen nga një burim ose burimet e palës së tretë.
- **Risku**: Risku në shfrytëzimin e mundësive duhet t’i përkasë koncesionarit. Koncesionari në përgjithësi pranon, për shembull, riskun operacional dhe/ose financiar të sigurimit të një shërbimi publik ose pune publike në këmbim të mundësisë për të nxjerrë të ardhura përmes shfrytëzimit të atij shërbimi ose të asaj pune. Mungesa e transferimit të riskut tek operatori ekonomik sugjeron ekzistencën e një kontrate të zakonshme publike, pra subjekt i zbatimit të plotë të Direktivës së Sektorit Publik⁵ ose të Direktivës së Shërbimeve⁶, më tepër se sa ekzistencën e një koncesioni që i nënshtrohet Direktivës së Koncesioneve. Kërkesa që risku të jetë pjesë e natyrshme e shfrytëzimit të mundësisë së koncesionit është theksuar nga Komisioni Evropian si më poshtë:

“..Tipari kyç i koncesioneve është e drejta e koncesionarit për të shfrytëzuar ndërtimin ose shërbimin e ofruar që jepet si shpërblim për ndërtimin e objektit ose ofrimin e shërbimit. Dallimi kryesor me prokurimin publik është risku i natyrshëm që përfshihet në një shfrytëzim të tillë të cilin koncesionari, zakonisht duhet ta mbajë duke bërë financimin e të paktën disa pjesëve të projekteve përkatëse.”⁷

Përkufizimi i koncesionit kuptohet më mirë duke përdorur ilustrime praktike. Shembujt e mëposhtëm janë të thjeshtë, dhe klasifikimi i një koncesioni do të varet nga detajet e koncesionit të caktuar të propozuar.

Koncesioni i punëve: Koncesionet janë përdorur shpesh për të ofruar projekte të mëdha të infrastrukturës, të tilla si ndërtimi dhe operimi i rrugëve, urave ose tuneleve. Kur koncesionari e merr të gjithë pagesën e tij me anë të tarifave të vendosura direkt ndaj përdoruesit, atëherë *shpërblimi* e ka prejardhjen nga "shfrytëzimi" i veprës dhe jo nga autoriteti kontraktor që akordon koncesionin. Koncesionari merr përsipër një *risk* financiar dhe operacional, kur ai financon ndërtimin e veprës dhe e operon atë pa një garanci se do të jetë në gjendje që të rikuperojë investimin e tij dhe të nxjerrë fitim gjatë periudhës së koncesionit. Ky është një shembull i një "koncesioni të punëve".

Nëse autoriteti kontraktor pranon që të paguajë koncesionarin në rast se të ardhurat nga përdoruesit e palës së tretë nuk mjaftojnë për t’i mundësuar koncesionarit që ai të rikuperojë investimet e tij, atëherë lind mundësia që tek koncesionari është transferuar risku i

⁴ Termi "tarifë koncesionare" do të thotë pagesa financiare apo monetare të marra nga koncesionari, por termi gjithashtu mund të mbulojë edhe përfitimet e tjera ose vlerat që rrjedhin nga puna ose shërbimi të cilat mund të mos jenë thjesht financiare.

⁵ Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

⁶ Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

⁷ Komisioni Evropian (2005), Komunikim mbi Partneritetet Publiko-Private dhe të drejtën Komunitare mbi Prokurimin Publik dhe Koncesionet, COM (2005) 569, Berlin, paragrafi 3.1.

pamjaftueshëm për veprat që janë subjekt i përkufizimit të koncesionit të punëve. Në këtë rast, ai mund të klasifikohet si një kontratë punësh.

Koncesioni i shërbimeve: Koncesionet janë përdorur edhe në projekte që kërkojnë funksionimin dhe mirëmbajtjen, por jo ndërtimin e veprave, për shembull, dhënia e një koncesioni për të operuar një hekurudhë ose port ekzistues, duke i vënë tarifë palëve të treta për përdorimin e këtyre objekteve, ose dhënia e një koncesioni për të administruar një mensë të qeverisë, ku përdoruesit e mensës paguajnë direkt për ushqim dhe pijen e blerë. Këto lloje koncesionesh janë shembuj të "koncesioneve të shërbimeve".

Kur, në shembullin e mësipërm të mensës së qeverisë, autoriteti kontraktor ofron objektin e mensës për përdorim nga ana e operatorit ekonomik dhe pranon gjithashtu që të paguajë operatorin ekonomik për të mbuluar shpenzimet bazë të administrimit ose për të subvencionuar një pjesë të shërbimit, atëherë kjo mbështetje mund të nënkuptojë se operatori ekonomik nuk mbart risk të mjaftueshëm që marrëveshja të jetë subjekt i përkufizimit të koncesionit të shërbimeve. Në këtë rast, kjo mund të klasifikohet si një kontratë shërbimesh.

Përdorime të ndryshme të termit “koncesion” sipas ligjeve kombëtare

Koncepti i koncesioneve të punëve dhe i koncesioneve të shërbimeve është një koncept i së drejtës së BE-së dhe duhet të interpretohet në përputhje me të drejtën e BE-së. Të drejta kombëtare mund të përcaktojnë koncesione të ndryshme. Si rezultat i kësaj, është e mundur që disa kontrata apo mundësi kontratash që konsiderohen si koncesione sipas të drejtës kombëtare nuk do të konsiderohen si koncesione për qëllimet e Direktivës së Koncesioneve. Për shembull, dhënia e të drejtës për të shfrytëzuar burimet natyrore, të tilla si nxjerrja e qymyrit, apo rregullimi i shërbimeve të taksive me anë të dhënies së licencave të operatorit mund të quhet "koncesion" sipas të drejtës kombëtare, por në përgjithësi nuk do të konsiderohet si koncesion për qëllime të Direktivës së Koncesioneve. Po ashtu, disa kontrata të cilat nuk konsiderohen si koncesione sipas të drejtës kombëtare mund të klasifikohen si koncesione sipas të drejtës së BE-së.

Prandaj është shumë e rëndësishme për të kuptuar dhe për të zbatuar përkufizimet e BE-së kur përcaktohet nëse një marrëveshje e propozuar është ose jo një koncesion për qëllime të Direktivës së Koncesioneve.

Koncesionet që përfshijnë një kombinim të punëve dhe shërbimeve

Kur koncesioni përfshin një kombinim të punimeve dhe shërbimeve është e nevojshme që të vendoset nëse koncesioni duhet të klasifikohet si një koncesion i punëve apo si një koncesion i shërbimeve. Dallimi midis dy llojeve të koncesionit është i rëndësishëm, pasi zbatohen disa ndryshimeve në regjimin ligjor. Për shembull, për koncesionet e shërbimeve janë në dispozicion përjashtime të ndryshme, ndërkohë që për koncesionet e punëve zbatohen rregulla të ndryshme të nënkontraktimit.

Në rastin e kontratave koncesionare të përziera që mund të ndahen, autoritetet dhe subjektet kontraktore janë të lira që të japin koncesione të ndara për pjesë të veçanta të kontratës së përzier. Megjithatë, në qoftë se pjesët e ndryshme që përbëjnë kontratën, janë objektivisht të pandashme⁸, atëherë rregullat që zbatohen, duhet të përcaktohen në funksion të objektit kryesor të kontratës në fjalë. Kështu, koncesioni që ka për objekt të tij si punët ashtu edhe shërbimet duhet të jepet në përputhje me dispozitat e zbatueshme të koncesioneve të

⁸ Sipas jurisprudencës së GJED-së, përcaktimi i pandashmërisë bëhet mbi bazë të parimit rast pas rasti duke marrë parasysh qëllimet e shprehura apo të supozuara të autoritetit kontraktor për të shqyrtuar aspektet e ndryshme që e bëjnë një kontratë të përzier si të pandashme, të mbështetur nga prova objektive që justifikojnë këto qëllime, dhe krijimin e nevojës për të lidhur një kontratë të vetme.

punëve, në qoftë se elementi i punëve karakterizon objektin kryesor të kontratës të veçantë në fjalë, dhe anasjelltas. Për shembull, një autoritet lokal vendos se ai dëshiron t'i japë një kontratë koncesioni një operatori ekonomik për administrimin e një qendre të artit për një periudhë 20-vjeçare. Autoritetet lokale kanë në pronësi ndërtesën e qendrës së artit. Shpërblimi që operatori ekonomik do të marrë, do të realizohet me anë të pagesave nga publiku që përdor objektet, të tilla si kafeneja, dhe të cilët paguajnë për të marrë pjesë në aktivitet që organizohen në qendrën e arteve, të tilla si ekspozitat e artit, filmat dhe produksionet teatrale. Autoriteti lokal kërkon si pjesë të koncesionit që operatori ekonomik fitues të realizojë punët e rinovimit gjatë pesë viteve të para të periudhës së koncesionit. Punët e rinovimit krijojnë një restorant dhe kuzhina të reja, përmirësojnë aksesin në ndërtesa për njerëzit me aftësi të kufizuara, përmirësojnë ashensorët, dhe instalojnë banja të reja. Në këtë rast, është e ligjshme të argumentojnë se objekti kryesor i koncesionit është operimi afatgjatë i qendrës së artit. Punët e rinovimit, të cilat janë pjesë e marrëveshjes së përgjithshme, mund të konsiderohen si dytësore në raport me objektin kryesor. Prandaj, koncesioni duhet të klasifikohet si një koncesion shërbimesh dhe jo si koncesion punësh.

Për informacion të mëtejshëm mbi Direktivën e Koncesioneve, shih Udhëzimin nr. 32 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Direktiva 2014: Koncesionet*.

Çfarë është një PPP?

Akronim PPP i referohet "partneritetit publik privat". Nuk ka ndonjë përkufizim të vetëm ose të thjeshtë të PPP-së, pasi termi mbulon një gamë të llojeve të ndryshme të kontratave dhe modeleve të tjera të ofrimit të punëve dhe shërbimeve.

PPP-ja mund të përshkruhet si formë e bashkëpunimit midis autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë të sektorit privat, shpesh me qëllim të sigurimit të financimit, ndërtimit, rinovimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës (punë) dhe/ose ofrimit të shërbimeve. Organizatat pjesëmarrëse shpesh quhen "partnerë", i cili është një term i përdorur përgjithësisht në kuptimin jo-ligjor.

Një tipar kyç i PPP-së ka tendencë të jetë ndarja ose transferimi i riskut tek partneri i sektorit privat, dhe PPP-të janë shpesh, por jo gjithmonë, me afat të gjatë.

Metodat e pagesës dhe të financimit ndryshojnë në bazë të PPP-së. Pagesat mund të bëhen nga autoriteti kontraktor ose rrjedhin nga palët e treta, siç janë përdoruesit e objekteve (rast në të cilin kontrata mund të klasifikohet si koncesion), ose nga një kombinim i burimeve. Financimi mund të vijë nga autoriteti kontraktor, pala e sektori privat, financuesit e jashtëm të tillë si bankat apo huadhënësit e tjerë, ose një kombinim i burimeve. Për shkak të natyrës së projekteve të PPP-së, dokumentacioni ligjor ka tendencë të jetë kompleks dhe me shumë nivele.

Struktura e PPPs-ë mund të jenë kontraktuale ose institucionale. PPP-ja institucionale (PPPI-ja) është një lloj i PPP-së që përfshin ngritjen e një subjekti të kombinuar të ofrimit të kapitalit, të tillë si një ndërmarrje me kapital të përbashkët ose ndonjë organizim tjetër sipërmarrjeje me kapital të përbashkët, në të cilën marrin pjesë si autoriteti kontraktor ashtu edhe pala e sektorit privat. Subjektit të krijuar i besohet realizimi i projektit të PPP-së së infrastrukturës ose shërbimeve, me pjesëmarrjen e vazhdueshme dhe aktive të partnerit të sektorit privat, së bashku me partnerin e sektorit publik.

Si zbatohen Direktivat ndaj PPP-ve?

Nuk ka ndonjë përkufizim ligjor të PPP-së në Direktivën e Sektorit Publik, në Direktivën e Shërbimeve apo në Direktivën e Koncesioneve, dhe termi nuk është përdorur në asnjë nga këto direktiva. Kuadri ligjor i BE-së nuk përmban një ligj për PPP-në ose ndonjë sistem specifik ligjor që rregullon zgjedhjen e partnerëve privatë për PPP-të nga autoritetet kontraktore. Kur

shtetet vendosin që të rregullojnë PPP-të më vete, nuk ka ndonjë kërkesë për legjislacion të veçantë për të mbuluar procedurat e dhënies së kontratave të PPP. Megjithatë, për procedurat e dhënies së PPP-ve do të zbatohet legjislacioni i prokurimit publik.

Sipas këndvështrimit të rregullave të prokurimit të BE-së, PPP-të janë ose kontrata publike (ose kontrata të ndërmarrjeve të shërbimeve), ose kontrata koncesionit (punët ose shërbimet) ose kontratat që janë të përjashtuara nga objekti i Direktivave. PPP-të që janë kontrata të përjashtuara dhe që janë me interes ndërkufitar, do të jenë subjekt i parimeve themelore të Traktatit, dhe do të zbatohen rregullat që rrjedhin nga këto parime, në veçanti parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe njohjes reciproke.

PPP-ja që cilësohet në bazë të Direktivës së Sektorit Publik si një kontratë publike duhet të jepet duke përdorur një nga procedurat e përcaktuara në atë Direktivë që zbatohet për kontratat publike. Autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë me kujdes procedurën më të përshtatshme të dhënies së kontratës në rastet kur jep kontrata të PPP-së, të cilat shpesh janë komplekse dhe zakonisht kërkojnë negociata mes palëve. Kur kontrata e PPP-së konsiderohet si mjaft komplekse dhe Shteti Anëtar ka miratuar dispozitat përkatëse të Direktivës së Sektorit Publik, atëherë dialogu konkurrues mund të jetë një procedurë e përshtatshme për t'u përdorur. Mund të jetë gjithashtu e mundur që kushtet të plotësohen duke rregulluar përdorimin e procedurës konkurruese me negociim.

Kur PPP-ja është koncesion do të zbatohet Direktiva e Koncesioneve.

Kur struktura është një PPPI, atëherë mund të përdoret procesi unik i BE-së i rregulluar nga Direktiva e Sektorit Publik (për kontratat publike), Direktiva e Shërbimeve (për kontratat e shërbimeve), ose Direktiva e Koncesioneve (për koncesionet) si për të caktuar partner e sektorit privat për PPPI-në ashtu edhe për t'i dhënë kontratën subjektit të përbashkët të realizimit të punës apo të shërbimit.

Koncesionet në sektorin e shërbimeve

Direktiva e Koncesioneve zbatohet për dhënien e koncesioneve të punëve ose shërbimeve nga subjektet kontraktore, me kusht që punët apo shërbimet të jenë të destinuara për ushtrimin e një prej aktiviteteve përkatëse në sektorin e shërbimeve.

Për informacion rreth katër sektorëve të rregulluar nga Direktiva e Shërbimeve dhe për llojet e subjekteve kontraktore të mbuluara, duke përfshirë diskutimin e asaj se çfarë është një ent publik shih Udhëzimin nr. 16 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Prokurimit nga shërbimet*.

Shënim praktik për përcaktimin e objektivit, prokurimin dhe menaxhimin e PPP-ve

PPP-të prirën të jenë kontrata komplekse që shpesh janë afatgjata. Ashtu si në rastin e të gjitha kontratave komplekse ose afatgjata, është shumë e rëndësishme që të garantohet se kërkesat vlerësohen me kujdes dhe objekti përcaktohet paraprakisht në mënyrë që specifikimet dhe kushtet e kontratës të jenë të plota dhe gjithëpërfshirëse duke bërë të mundur që autoriteti kontraktor dhe operatori apo operatorët ekonomikë të kuptojnë plotësisht natyrën dhe pasojat e projektit gjatë afatit të kontratës.

Procesi i prokurimit duhet të testojë në mënyrë rigorozë propozimet e operatorëve ekonomikë për të siguruar që ato të plotësohen dhe që do të vazhdojnë të përmbushin kërkesat e autoritetit gjatë gjithë afatit të kontratës. Për informacion të mëtejshëm mbi procedurat përkatëse të prokurimit dhe dhënien e koncesioneve shih Udhëzimin nr. 10 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Procedurat e prokurimit publik dhe kur mund të përdoren ato*, dhe Udhëzimin nr. 31 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Direktivat 2014: Koncesionet*.

Menaxhimi i vazhdueshëm dhe aktiv të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj është gjithashtu me rëndësi kritike për ofrimin e suksesshëm dhe funksionimin e koncesionit. Për më shumë informacion, shih Udhëzimin 21 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Matja e performancës*, dhe Udhëzimin nr. 22 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Menaxhimi i kontratës*.

Informacion i mëtejshëm

Botime

Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli D3, Botimet e OECD-së, Paris.

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2014), *Direktivat e BE-së 2014: Koncesionet*, Udhëzimi 31 Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Menaxhimi i kontratës*, Udhëzimi 22, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Matja e performancës*, Udhëzimi 21, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Prokurimi nga shërbimet*, Udhëzimi 16, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Procedurat e prokurimit publik*, Udhëzimi 10, Botimet e OECD-së, Paris.

Burime të tjera

OECD (2012), *Rekomandimet e Këshillit për Parimet për Qeverisjen Publike të Partneriteteve Publiko-Private*, Botimet e OECD-së, Paris.

<https://www.oecd.org/governance/budgeting/PPP-Recommendation.pdf>

Komisioni Evropian (2007), *Komunikimi Interpretues mbi zbatimin e të drejtës së Komunitetit për Prokurimin Publik dhe Koncesionet për PPPI-në*, Bruksel.

<http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/index.cfm?n=10&adv=0&coteld=3&year=2007&number=6661&dateFrom=&dateTo=&serviceld=&documentType=&title=&titleLanguage=&titleSearch=EXACT&sortBy=NUMBER&sortOrder=DESC&CFID=3376650&CFTOKEN=e3d6ab2394942a90-576C2CDC-B72D-F7E5-FC703A6E00BE2B8C&version=ALL&fuseaction=list>

Faqja e internetit e OECDs-së për çështjet e konkurrencës në Partneritetet Publiko-Private:

<http://www.oecd.org/competition/competitionissuesinpublic-privatepartnerships.htm>

Faqja e internetit e Komisionit Evropian për prokurimin publik dhe kontratat e koncesionit ka qenë e disponueshme në internet që nga prilli i vitit 2016:

http://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/new/index_en.htm

Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për faqen e internetit të Evropës për Qendrën Ndërkombëtare PPP të Ekselencës: <http://www.unece.org/icoeppp.html>